



One Albania SHA

Adress: "Muhedin Ulagami" St., "Square 21" Complex, Tirana, Albania

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certified: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 | NIPT: J61814094W

ANEKSI NR. 1/1 PLANI TARIFOR

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE per kete plan tarifor si dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifaf përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani Tarifor ONE OFFICENET 5G UNLIMITED

Plani ONE OFFICENET 5G UNLIMITED	
Pajtimi Mujor	2,500 Lekë
Internet	Pa Limit
Internet 5G	2 TB

Shënime:

1. Tarifa per instalimin e shërbimit për kontrata me afat 12 muaj është 2,000 Lekë e cila paguhet vetëm njëhere dhe reflektohet në faturën e parë mujore, ndërsa për kontrata me afat 24 muaj është pa pagesë.
2. Të gjitha tarifaf e mësipërme janë me TVSH të përfshirë.
3. GB e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk transferohen në muajt e ardhshëm.
4. Njësitë e Internetit te mësipërme nuk janë të vlefshme për t'u përdorur në Roaming.
5. Përlllogaritja e konsumit të internetit do të bëhet cdo 100 KB.
6. Pas konsumimit të njësite te internetit të përfshira në paketë, klientet do te vazhdojne lundrimin në internet por me shpejtësi të kufizuar (256 kbps).
7. Maksimumi i zonave të lejuara për HomeNet është 5 zona. Aktivizimi i 2 zonave të para është falas, 3 zonat shtesë janë me një pagesë prej 300 lekë/zone.
8. Plani OFFICENET 5G Unlimited do të ofrohet me kontratë pajtimi me kohëzgjatje 12 mujore dhe kontratë pajtimi me kohëzgjatje 24 mujore.
9. Pagesa fikse mujore dhe njësitë e internetit të përfshira për muajin parë të aktivizimit do te jetë proporcionale me ditët e mbetura të muajit te aktivizimit te kontratës.
10. Pagesat fikse mujore në vijim do të aplikohen cdo datë 1 të muajit kalendarik. Në faturën parë mujore do të reflektohet tarifa e instalimit (nëse ka) dhe vlera e pagesës mujore fikse, dhe në vijim në çdo faturë mujore të lëshuar, do të shfaqet vlera e pagesës mujore fikse.
11. Kohëzgjatja minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vleren e tarifës mujore fikse per të gjithë muajt e mbetur deri ne perfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
12. Ne rastet kur pajtimtari ka perfituar nga nje oferte promocionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promocionale, dhe vendos zgjidhje te parakohshme te kontratës, së bashku me detyrimet e përmenduara më sipër duhet te paguaj edhe perfitimet nga oferta promocionale (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promocionale).
13. Per të përfituar nga ofertat promocionale te komunikua nga ONE, pajtimtari duhet te shlyeje detyrimet sipas afatit te përcaktuar ne faturë.
14. Të gjitha pajisjet e dhëna Pajtimtarit nga ONE për ofrimin e shërbimit të internetit, janë pronë e ONE dhe i jepen në përdorim Pajtimtarit për të gjithë kohëzgjatjen e shërbimit. Pajtimtari detyrohet që në rastin e zgjidhjes ose përfundimit të kontratës të pajtimit, t'i kthejë ONE-it këto pajisje.
15. Në rast se Pajtimtari zgjidh në mënyrë të parakohshme kontratën e pajtimit për çfarëdo arsyesh dhe nuk i kthen ONE-it pajisjet HomeNet në kuti së bashku me të gjithë aksesorët, ose kur konstatohet prej ONE se pajisjet e dhëna në përdorim pajtimtarit janë dëmtuar prej tij, atëherë Pajtimtari detyrohet t'i paguajë ONE-it si penalitet vlerën prej 6,000 lekë, krahas detyrimeve të tjera monetare që rrjedhin prej kontratës së pajtimit të lidhur midis palëve.
16. ONE Albania ka të drejtë të aplikojë një ndryshim të tarifave të një apo më shumë shërbimeve bazuar në ndryshimin mesatar vjetor te indeksit te cmimeve te konsumit te publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), duke ju referuar treguesit te vitit paraardhes. Operatori ka te drejte te aplikojte kete ndryshim jo me shume se nje here ne vit si dhe jo me vone se 2 muaj pas publikimit te INSTAT. 19)
17. Pajtimtari merr përsipër: (i) të përdorë pajisjet vetëm për qëllimin që i janë dhënë në përdorim, duke respektuar të gjitha kushtet e përdorimit të pajisjeve si dhe do të sigurojë që pajisjet të funksionojnë brenda kushteve teknike të kërkuara; (ii) të ruajë pajisjet nga dëmtime të ndryshme që mund t'i ndodhin si pasojë e ndryshimeve në rrymën elektrike, nga dëmtime që mund t'i shkaktohen nga faktorë atmosferikë; (iii) si dhe të ruajë pajisjet nga ndërhyrje të paautorizuara të personave të tretë.